



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 5171/2 Prot

Fier më, 30/04/2026

PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 30.04.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 13:00. Të pranishëm në mbledhje 43 këshilltarë.

Znj. Fatbardha Merkaj

Përsëritet të nderuar këshilltarë! Fillojmë mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak. Pranë sekretariatit të Këshillit Bashkiak është paraqitur kërkesa për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak nga ana e Kryetarit të Bashkisë Z.Armando Subashi me Nr. 5036 Prot, datë 21.04.2026 me projektvendimin "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Mars 2026". Gjithashtu në sekretarinë e Këshillit Bashkiak është paraqitur edhe kërkesa për mocion shkarkimi e Grupit të Këshilltarëve të Partisë Socialiste të Këshillit të Bashkisë Fier me Nr. 5113 Prot, datë 22.04.2026, pranë Bashkisë Fier. Në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit Bashkiak, Fier, të zhvilluar më datën 22.04.2026 u paraqit nga ana e administratës së Bashkisë Fier edhe projektvendimi :” Për trajtimin me ndihmë financiare me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Sazan Allajbeu, fshati Portëz, NjA Portëz, i dëmtuar nga zjarri i datës 12.03.2026. Pra këto janë pikat e rendit të ditës të mbledhjes së sotme të Këshillit të Bashkisë. Kush është dakord me rendin e ditës?”

Z.Ilia Fili

Znj.nënkryetare, a mundet një sekondë?

Znj. Fatbardha Merkaj

Po.

Z.Ilia Fili

Kjo mbledhje është e zakonshme apo e jashtëzakonshme?

Znj. Fatbardha Merkaç

Kjo është mbledhje e zakonshme e Këshillit të Bashkisë.

Z.Ilia Fili

Atëherë, në mbledhjen e fundit kam shtruar një problem. Kam kërkuar që te rendi I ditës, pikat e para, të vendosen kërkesat, sugjerimet që vijnë nga ne këshilltarët në Këshill për problemet që konstatojmë në zonat ku ne jemi.

Znj. Fatbardha Merkaç

Po, janë vendosur, janë vendosur në fund të rendit të ditës. Këtë radhë janë vendosur në fund të rendit të ditës.

Z.Ilia Fili

Dhe arsyen e dini mirë përse e kam kërkuar në fillim.Nqs do të ketë një mbledhje tjetër të afërt dhe i shtojmë atje, është tjetër gjë.

Znj. Fatbardha Merkaç

Po shpresojmë domethënë që të jetë mbledhja e afërt për të parë të gjitha problematikat që janë nëpër zonat e bashkisë.

### **Pika e parë e rendit të ditës.**

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **31.03.2026**.
3. Kërkesë për mocion për shkarkimin e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Fier.
4. Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin Mars 2026".
5. Projektvendim:" Për trajtimin me ndihmë financiare me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Sazan Allajbeu, fshati Portëz, NjA Portëz, i dëmtuar nga zjarri i datës 12.03.2026.
6. Diskutime dhe komente

Znj. Fatbardha Merkaç



Kush është dakord për rendin e ditës?

Pro 43 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet

**Pika e dytë e rendit të ditës.**

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **31.03.2026**.

Znj. Fatbardha Merkaç

Ju ka ardhur në mënyrë elektronike kryetarëve të grupeve. Ka ndonjë vërejtje? Kush është dakord?

Pro 43 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet

**Pika e tretë e rendit të ditës.**

Kërkesë për mocion për shkarkimin e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Fier.

Znj. Antoneta Çunaj

Me leje?


Znj. Fatbardha Merkaç

Urdhëro!

Znj. Antoneta Çunaj

Kam një kërkesë të cilën dua ta lexoj përpara këshillit përpara se të hidhet për votim kjo pikë e rendit të ditës.

Ju bëj me dije të gjithë pjesëmarrësve në këtë... që është hera e parë pas konstituimit tim në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak, ku kam marrë 49 këshilltarë, nga të cilët 49 këshilltarë kanë



votuar pro meje, me propozim të Partisë Socialiste. Edhe sot është hera e parë që në këtë mbledhje Këshilli marrin pjesë 43 anëtarë dhe këtu i përgëzoj të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak, majtas dhe djathtas. Dhe për këtë qëllim, paraqes një kërkesë timen përpara të gjithë juve, mediave... për mediat kam një sugjerim, që kopjen e plotë të shkresës që i ka mbërritur mediave do ta jap origjinale që të mos keqinterpretohen fjalët e mia. Të nderuar këshilltarë, siç jeni njohur nga pika e rendit të ditës, është edhe shkarkimi im nga detyra e kryetarit të Këshillit Bashkiak. Këtë detyrë unë e kam pranuar dhe u votua jo vetëm nga këshilltarët socialistë, pasi ishte propozimi i tyre, por u votua me votim të fshehtë nga të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak, duke përfshirë edhe këshilltarët e opozitës. Për këtë arsye, siç ma besuat të gjithë ju këtë detyrë, e kisha obligim t'u drejtohesha të gjithë juve si këshilltarë, dhe jo vetëm këtyre socialistë, që t'ju falënderoj të gjithëve për zemërsisht për çdo vendimmarrje të drejtë që kemi marrë gjatë këtij mandati, të cilin e ka shërbyer më së miri zhvillimit ekonomik e social të bashkisë sonë. Jam krenarë që së bashku me ju, të gjitha vendimet e marra janë miratuar nga prefekti I qarkut dhe asnjë prej këtyre vendimmarrjeve nuk është kthyer për ndonjë paligjshmëri apo të jetë hapur ndonjë proces gjyqësor. Pa ju të gjithë së bashku, unë nuk do të mundja të realizoja me sukses vendimet e marra me shumicën dërrmuese të anëtarëve të këtij Këshilli. Duke qenë se kërkesa për shkarkimin tim nga detyra e kryetares së Këshillit është kërkuar në këtë mbledhje nga një pjesë e anëtarëve të Këshillit Socialist, unë nuk e quaj të nevojshme të realizohet votim i fshehtë për qenien ose jo si kryetare e Këshillit Bashkiak, pasi me iniciativën time personale, të mirëmbledhur, po jap dorëheqjen e parakohshme për arsye personale, duke qëndruar thjesht anëtare e Këshillit, nga forca politike që më ka besuar. Ju falënderoj të gjithëve për besimin që më keni dhënë gjatë gjithë kësaj periudhe. Përpara se ta dorëzoj, gjatë gjithë kësaj periudhe, në të gjitha rrjetet sociale, pa përjashtim, përmes telefonatave dhe përmes takimeve të ndryshme me qytetarët e qytetit tim, kam marrë vlerësime të shumta në lidhje me atë çka jam formuar unë, në lidhje me familjen time, që kam një familje të konsoliduar, në lidhje me punën time në biznes si avokate, që nga momenti I themelimit të avokatisë e deri më sot, dhe në lidhje me punën si kryetare këshilli. Kështu që I falënderoj të gjithë ata që më kanë besuar dhe që do të më besojnë përsëri, sepse unë do t'i përkushtohem deri në fund vendimmarrjeve të drejta që do të merren në këtë Këshill, gjithmonë në interes të këtij komuniteti. Përfundimisht, ju falënderoj edhe një herë dhe nuk kam tjetër për të thënë. Rroftë Partia Socialiste që më besoi deri në këtë moment të rëndësishëm! Kaq kisha.

Znj. Fatbardha Merkaç



Atëherë, siç edhe e dëgjuat edhe vetë, s'është e nevojshme të bëjmë procedurat e shkarkimit të zonjës Antoneta Çunaj. Faleminderit Antoneta! Ftoj kryetarët e grupeve të bëjnë propozimin për kryetarin e ri të Këshillit bashkiak. Po , Marjus.

Z.Marjus Voja

Në emër të grupit të këshilltarëve të partisë socialiste kemi një propozim për kryetar të Këshillit Bashkiak. Të nderuar këshilltarë, pas shpalljes së vakancës në pozicionin e kryetarit të Këshillit Bashkiak, grupi i këshilltarëve të Partisë Socialiste, pas konsultimeve të brendshme dhe pas vlerësimit të meritokracisë profesionale , propozon si kandidat për postin e kryetarit të Këshillit Bashkiak Fier, zotin Melsi Bogdani. Kandidatura e zotit Bogdani vjen si një garanci për vijimësinë e proceseve vendimmarrëse, duke u bazuar në integritetin e tij moral dhe përvojën e spikatur në administratën publike dhe qeverisjen vendore. Besojmë se zoti Bogdani zotëron aftësitë e duhura drejtuese për të siguruar kohezion nëpërmjet anëtarëve të Këshillit dhe zbatimin rigoroz të ligjit në çdo akt të këtij organi. Kërkojmë që kandidatura e mësipërme t'i nënshtrohet procedurës së votimit të fshehtë nga ana e Këshillit Bashkiak, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Këshillit Bashkiak. Për gjithë grupin e këshilltarëve socialistë, kanë firmosur mbi 1/3 e këshilltarëve. Mund t'jua vë në dispozicion. Njëkohësisht ftoj të gjithë kolegët ta votojmë Z.Melsi Bogdani

Znj. Fatbardha Merkaç

Nga grupet e tjera politike ka ndonjë propozim?

Z.Kreshnik Dapi

Përshëndetje! Ne si grup i Social Demokratëve, nuk kemi propozim.


Znj. Fatbardha Merkaç

Ka njëri tjetër? Jo.

Z.Armando Çupa

Nënkryetare, më fal! Meqenëse ka ardhur një kërkesë tjetër nga Partia Socialiste për zëvendësimin e anëtarit të komisionit... meqenëse zoti Melsi Bogdani është kandidat për kryetar dhe njëkohësisht është kryetar i komisionit të votimit...mendoj që shkresa që ka ardhur nga Partia Socialiste, duhet të lexohet tani.

Z.Marjus Voja



Më fal zonja nënkryetare kemi dhe një propozim tjetër! Meqenëse zoti Bogdani është në cilësinë e kandidatit për kryetar Këshilli Bashkiak, ne kërkojmë zëvendësimin e tij si kryetar i komisionit të votimit me zotin Florian Lika.”

Znj. Fatbardha Merkaj

Atëherë, ftoj komisionin e votimit të fillojë procesin e votimit, të fillojë procedurën e zgjedhjes së kryetarit të ri të Këshillit. Pesë minuta pushim që të përgatiten materialet.

Z.Florian Lika

Fillojmë procesin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të ri të Këshillit Bashkiak Fier. Ftohen të gjithë këshilltarët të marrin pjesë në votim.

Në përfundim të procesit të votimit, në kutinë e votimit u gjetën 43 fletë votimi të vlefshme. Pas numërimit të fletëve të votimit rezultuan:

Pro 42 vota .

Kundra 1 votë.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Urime kryetarit të ri të Këshillit Bashkiak Fier, Z.Melsi Bogdani.

Znj. Fatbardha Merkaj

Ftoj kryetarin e ri të sapozgjedhur, duke i uruar suksese, të marrë drejtimin e mbledhjes!

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, përfshëndetje të gjithëve! Ndjes për emocionet e para. Dua t`ju falenderoj të gjithëve për mbështetjen, të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak, edhe ata që nuk janë të pranishëm në seancë sot. Një falenderim të veçantë për ish-kryetaren për punën e bërë deri tani. Dua të saktësoj që lidhja ime me ish-kryetaren është një miqësi e jashtëzakonshme dhe nuk ka lidhje fare për pjesën e rizgjedhjes së kryetarit të Këshillit. Ajo është pjesë e Partisë Socialiste ashtu siç jemi dhe ne, e familjes së Partisë Socialiste.

Kështu që, faleminderit shumë, shumë, shumë për mbështetjen të gjithë këshilltarëve që janë të pranishëm! Falenderim të veçantë për kryetarin e Partisë Socialiste për besimin e dhënë, për

deputetët që janë të pranishëm në sallë për besimin. Faleminderit mediave për pasqyrimin e mbledhjes së Këshillit me rigorozitet.

Do të mundohemi që Këshilli, nga kjo ditë e në vazhdim, të jetë shumë transparent dhe mungesa juaj ka qenë gjatë gjithë tre vjeçarit, do të mundohemi që të jeni të pranishëm në çdo mbledhje të Këshillit. Shumë, shumë faleminderit dhe shpresoj t'ju kthejmë me punë dhe ta ngremë Këshillin në një nivel më të lartë se ç'ka qenë deri në punën e tanishme. Shumë, shumë faleminderit!

Tani, para se të kalojmë në rendin e ditës, ndonjë koleg dëshiron fjalën? Po, inxhinier.

Z.Ilia Fili


Së pari dua të të uroj punë të mbarë! Të jesh i dashur me të gjithë dhe veçanërisht me ne të opozitës, siç ke qënë më parë kur ishe anëtar i thjeshtë.

Z.Melsi Bogdani

Faleminderit!

Z.Ilia Fili

Unë e kërkova fjalën sepse dua të vë gishtin në një plagë, që ne e kemi këtu në këshill. Unë e lexova me shumë vëmendje mocionin, siç kam lexuar të gjitha materialet që vijnë në Këshill. Natyrisht aty ka disa pika. Por për një pikë nuk jam dakord, që aty thuhet që “nuk ja ka dhënë fjalën anëtarëve të këshillit kur kanë kërkuar fjalën”. Mendoj që kjo pikë nuk qëndron dhe mendoj që kërkuesit e këtij mocioni duhet ta heqin këtë si pikë, pasi para çdo votimi ish-kryetarja ka thënë tekstualisht “E do njëri tjetër fjalën?”, pra nuk i është mohuar e drejta e fjalës askujt në këtë Këshill. Ndërsa për sa i përket pikave të tjera natyrisht ato qëndrojnë. Jo vetëm qëndrojnë por ato janë pika që janë ngritur me forcë nga krahu këtej, bile shpesh herë dhe me ngritje zëri, duke thënë “Po shkelni rregulloren, po shkelni rregulloren”. Dhe çuditërisht ky mocion vjen nga grupi i mazhorancës. Unë e konsideroj veten, pavarësisht se vij nga një forcë politike, e konsideroj veten time si një qytetar, kur kam ardhur në këtë këshill Ashtu siç konstatoj të gjithë kolegët që janë këtu, qytetarë, vijmë nga forca politike, por mbajmë përgjegjësi qytetare. M gjith zëri është ngritur, qoftë për numrin e madh të materialeve që vijnë këtu, qoftë për dokumentet pa vulë dhe pa firma etje etje, menjëherë ato kanë kaluar dhe grupi i mazhorancës ka heshtur, kanë ngritur kartonin menjëherë. Dhe unë prisja sot, që grupi i mazhorancës, natyrisht mocioni është pjesë e një autokritike, por duhet të ishte edhe më e hapur duke pranuar që një pjesë e këtyre gabimeve nuk janë vetëm thjeshtë të ish-kryetares, por edhe e



jona si këshilltarë. Pse e shtroj këtë pyetje? Sepse mua nuk më pëlqen, pavarësisht se jam pjesë e opozitës, por jam qytetar dhe më dhëmb, sepse dua të shtrojë problemet e qytetit tim.

Do t'ju kujtoj që kur analizuam programin ekonomik financiar të vitit 2024 në këtë Këshill, jo analizuam, na erdhi thjeshtë si informacion sepse këtu ka një absurditet që ne si këshill miratojmë programin prognozë, por nuk miratojmë nuk shqyrtojmë rezultatin e analizës. Kur pamë që investimet kapitale për vitin 2024 ishin realizuar 15% mgjth unë ngrita zërin me forcë sepse një nga detyrat tona kryesore është pikërisht kjo që ne si anëtarë këshilli të ndjekim pikërisht këtë punë, çfarë do të bëhet me investimet në çdo sektorë të punës së bashkisë. Erdhëm tek analiza e vitit 2025 Ky rezultat ishte 27 përqind. Dhe çuditërisht miratojmë, kalimin e fondeve me miliarda lekë nga një vit në tjetrin. Dhe do të themi që kemi bërë punë të mirë ne si Këshill që kemi lejuar një gjë të tillë? Kjo është një plagë, ajo për të cilën fola më lart. Dhe unë gjithmonë kam kërkuar që kolegët e mi gjyhmone ta ngrenë zërin pavarësisht se janë të së njëjtës forcë politike me administratën. Kur shikojmë një fenomen të tillë ne duhet ta frenojmë, duhet të kërkojmë llogari. Po marrë rastin më të thjeshtë. Mbase ju kujtohet. Unë i kam bërë propozimin bashkisë këtu që, të na mbajnë nga lekët tona dhe të blejmë bojë të bardhë që të vijëzohet rrugët e qytetit. Të blejë nga lekët tona sepse mbase nuk ka fonde Bashkia. Kemi një vit e gjysëm që kemi miratuar vendosjen e semaforëve në qytet dhe kam shtruar me forcë që semaforët nuk janë bukuri, janë domozdoshmëri, janë siguri për jetën. Po të shikoni, më fal që do ta them por kemi ngritur një park, unë e kam pranë shtëpisë, ka një shatërvan të madh, ka dhe 9 shatërvane të vegjël që sinqersht më erdhi turp kur dikush, një nga ata pensionistët më tha mua duke e ditur që isha anëtrë këshilli, i keni kthyer këta si “arkivole” sepse ata nuk punojnë më. Pra për këtë e shtrova problemin unë që grupi duhet ta analizojë situatën dhe të mbajë përgjegjësitë dhe jo të kalojë direkt në votim pro, pavarësisht nëse ka apo ska probleme të brendshme. Më kuptoni, jua shtroj këtë kërkesë si qytetarë, mbase edhe nga eksperiencia ime. Është domozdoshmëri që të mendojmë më të mirën e këtij qyteti. Më falni që ju mora disa minuta. Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Shumë, shumë faleminderit inxhinier. Unë do t'i kem parasysh të gjithë sugjerimet tuaja. Faleminderit edhe për urimin që më dhatë. Bile që në mbledhjen e ardhshme do të mundohem që kjo pika e fundit, diskutime dhe komente, të gjejë vendin e duhur ose aty tek pika e fundit e shikoj dhe e kam parë prej kohësh që asnjë diskutim dhe asnjë koment nuk bëhet sepse këshilltarët largohen

të gjithë nga salla. Kështu që nuk diskutohet asnjë problematikë e qytetarëve. Shumë faleminderit. Kalojmë në vazhdim.

Z.Kreshnik Dapi

Me leje!

Z.Melsi Bogdani

Po.


Z.Kreshnik Dapi

Tani në thunjëza për replike mqs Ilia përmendi disa detaje, që për ne kanë qenë shumë sensitive, që kanë të bëjnë me punën e këtij këshilli dhe në njëfarë mënyre ishin shkak ose rrjedhoja e gjithë kësaj që ndodhi këtu sot. Unë në radhë të parë të përshëndes, të uroj shumë suksese në këtë detyrë aq të lartë, e kaq serioze, dhe të jap një këshillë në radhë të parë si mik.

E vetmja gjë që nuk na sjell keq, nuk na dëmton dhe nuk na fut në rrugë të gabuar është zbatimi i ligjit dhe i rregullores. Ajo që ne kemi kërkuar me forcë mbasi ne që kemi ardhur nga grupe më të vogla e kemi ndjerë atë trysinë ose arbitraritetin tek tuk... Për pjesën e mocionit që përmendi Ilia, meqë unë jam anëtar i kryesisë dhe votova pro futjes në rendin e ditës të atij mocioni, mocioni është totalisht i plotë. bile në gjykimin tim me aq sa kam reflektuar unë, kur e kam kërkuar aty mund të bëhen edhe disa detaje të tjera, të jemi të sinqertë, mos të fshehim këtë, por unë e falënderoj Antonetën për kontributin që dha në atë mënyrën e vet, për aq sa dha, por fakti tregoi që mënyra si e drejtoi dhe si punoi nuk ishte e duhura, prandaj dhe erdhëm sot në këtë vendimmarrje.

Për pjesën tuaj dhe për atë merakun që ka kolegu Ilia, tek rendi i ditës, tek zëri i këshilltarëve, mjafton të mbash si busull rregulloren e Këshillit Bashkiak. Aty është një nen i posaçëm që jep formatin ose modelin tip të rendit të ditës. Dhe unë të ftoja që sot, sepse s'kemi pse humbim kohë, po ta kujtoj që të qëndrosh strikt atij formati. Për dy arsye: e para, e kemi votuar vetë unanimisht, dhe e dyta, është një model, një format shumë i saktë që i jep mundësi qytetarëve, këshilltarëve, grupeve të interesit e të gjithë të marrin pjesë në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Përveç kësaj, të kujtoj që gjendja e këshillit është alarmante. Jemi pa zyra. Të dal prapë te ajo historia e vjetër. Jemi pa bazë materiale. Jemi, siç e thatë dhe vetë në fillim të mbledhjes ku media akoma diskutohet të hyjë apo mos të hyjë në një mbledhje këshilli kur mbledhjet e këshillit ligjërish janë të hapura, janë transparente për publikun. Kemi mangësi shumë të theksuara, mbi ty, përveç se kjo

 9

nuk është privilegj, e jotja tanimë është një mision, sepse dhe koha është e kufizuar. Kemi shumë pak muaj, 12 apo 13 muaj mos gaboj, që mund të bëjmë ca gjëra të mira për qytetarët. Për disa gjëra është pak, por për disa gjëra të tjera është shumë kohë, dhe kemi mundësi ta tregojmë veten se kush jemi në të vërtetë. Të uroj suksese dhe ne do na kesh krah, pavarësisht kritikave. Nga kritika nuk të gjen gjë, përveç se del mirë.

Z.Melsi Bogdani

Faleminderit!

Znj.Antoneta Çunaj

Me leje?

Z.Melsi Bogdani

Po Antoneta!

Znj.Antoneta Çunaj


Faleminderit për fjalën! E para njëherë që... mua më vjen keq që... të nderuar këshilltarë, të flasim për një mocion... shkarkimi tim... ndërkohë që unë dhashë vetë dorëheqjen . Por megjithatë do t'i bëj me dije disa gjëra.

Së pari, Këshilli i Bashkisë Fier ka vepruar ... edhe me kryesinë e Këshillit edhe me këshilltarët e Këshillit. Përsa i përket këshilltarëve socialist dhe kryesisë së këshillit, asnjëherë dhe asnjëherë të vetme, nuk më është bërë prezent ndonjë mangësi apo ndonjë parregullësi e vogël në lidhje me ecurinë e çdo mbledhjeje të Këshillit Bashkiak. Asnjëherë.

Një. Të gjitha procesverbalet, si të kryesisë, edhe të Këshillit, të grupit të Partisë Socialiste, të gjitha janë procesverbalet, Më thoni një rast që është ngritur një këshilltar i grupit të Partisë Socialiste, nga ata që kanë firmosur shkarkimin tim, që ka konstatuar dhe më ka thënë që ke këtë parregullësi , asnjëherë. Por unë nuk i futem kësaj se... e para mqs u futët, po i futem.

E dyta, e dyta. Në kryesinë e Këshillit asnjë nuk ka votuar kundër rendit të ditës. Çfarë do të thotë? Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier ka vepruar me pozitë-opozitë dhe të gjitha procesverbalet janë të miratuara nga të tërë anëtarët e kryesisë së Këshillit.

E treta. E treta, që janë gënjeshtër, prandaj po them... Po unë i futa kësaj, por mqs po thoni gënjeshtër, po vazhdoj. Tani po them në lidhje me, me pjesën e materialeve, nuk është e vërtetë që



materialet sipas rregullores brenda afatit pesë ditor kanë ardhur të paplotësuar, në asnjë rast, kanë ardhur të firmosura dhe të vulosura.

Z.Melsi Bogdani

Të lutem... Duke qenë se ju bëtë një akt shumë fisnik me dhënien e dorëheqjes... Mocioni ka rënë dhe nuk ka pse të diskutohet fare për të. Absolutisht! Neta të lutem... kalojmë në vazhdimin e rendit të ditës të lutem. Jemi në pikën katër

#### **Pika e katërt e rendit të ditës.**

**Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin Mars 2026".

Z.Melsi Bogdani

Është mbledhur komisioni, ka ndonjë kush për të diskutuar, asnjë gjë, atëherë hedhim në votim.

Pro 43 vota .

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

#### **Pika e pestë e rendit të ditës.**

**Projektvendim:** Për trajtimin me ndihmë financiare me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Sazan Allajbeu, fshati Portëz, NjA Portëz, i dëmtuar nga zjarri i datës 12.03.2026.

Z.Melsi Bogdani


Është mbledhur komisioni përkatës për këtë?

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë, komisioni është mbledhur me prezencën e këshilltarëve Kreshnik Dapi, Marjus Voja, Ramadan Mehmetaj dhe Endri Jaupaj dhe e ka miratuar me 4 vota pro projektvendimin dhe ja kalojnë këshillit për miratim.

Z.Melsi Bogdani

Kryetarët e grupeve kanë diçka për të shtuar për këtë pikë? Pyetje ka? Jo. E hedhim në votim.

 11

Pro 43 vota .

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

**Pika e gjashtë e rendit të ditës.**

Diskutime dhe komente.

Z.Melsi Bogdani


Pikën gjashtë, inxhinier, diskutime dhe komente , në mbledhjen pasardhëse do ta kalojmë fiks pas miratimit të procesverbalit dhe do ta diskutojmë me rigorozitet. Shumë faleminderit të gjithëve!

Ky procesverbal ka 12 (dymbëdhjetë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit

Z. Arnando Çupa.

**Sekretar i Këshillit**


**Arnando Çupa**



**Kryetar i Këshillit**

**Melsi Bogdani**



Këshilltar  
Majlis Vëjz  


Rrapifjeka  


Eudri Jaupaj  
